

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.
ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. _____ Prot

Datë 03.09.2026

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË
ANKIMIT**

Data: 03.09.2026

Drejtuar: **Operatorit Ekonomik "Niem"** shpk me NIPT K36609610Q

Autostrada Bilisht- Korçë, Km. i 3, Bitinckë.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Klasike

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur-Punë Publike-prokurim me mjete elektronike

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-93644-07-16-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Ndërtim ujësjellësa dhe nënobjekte të furnizimit me ujë dhe përmirësim rrjetesh ekzistuese në Rajonin Korçë.

Fondi Limit: 108,331,684.83 (njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër pike tetëdhjetë e tre) Lekë pa tvsh.

Kohezgjatja e Kontrates/ose afati për zbatimin e saj: 28 javë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 26.08.2026

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 55 datë 31 Gusht 2026

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☒ X

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☐

A) Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto ² X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit ☐ ☐	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanisë ☐ ☐	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐ ☐	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit ☐ ☐	pikët 5

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE Ndrejoni sh.p.k & Ndertimi sh.p.k

K31329048I; K11325002C

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera

78,616,550 (shtatëdhjetë e tetë million e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikeve të marra: 276.45 Pikë

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Niem shpk

K36609610Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera

81,253,763 (tetëdhjetë e një milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikeve të marra: 288.90 Pikë

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. T&XH shpk

L72121504I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera

81,989,195.30 (tetëdhjetë e një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tridhjetë) Lekë pa tvsh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikeve te marra:0

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Nika shpk

J76705047U

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera

84,754,374.60 (tetëdhjetë e katër milion e shtatqënd e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikeve të marra: 0 Pikë

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. BOE "LIQENI VII" sh.p.k,"

K01730502W; L91310511L

IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera

94,189,999.05 (nëntëdhjetë e katër milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë zero pesë) lekë pa tvsh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikeve të marra: 263.70 Pikë

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. HASTOÇI

J62028009B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera

94,802,009.40 (nëntëdhjetë e katër milion e tetëqind e dy mijë e nëntë pikë dyzet) lekë pa tvsh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikeve të marra: 270.60 Pikë

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. BOE: “Ed Konstruksion” sh.p.k & “Inerti” sh.p.k K61625001I; J66926804L; K26625603U
&Artyka II” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera

98,984,487.00 (nëntëdhjetë e tetë million e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Totali i pikeve të marra: 259.80 pikë

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. T&XH shpk

L72121504I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Operatori Ekonomik T&XH shpk skualifikohet nga procedura e prokurimit të sipërcituar për shkak se nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar shtojcen 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” ku përcaktohet se:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

- a. NP – 1 B (Punime gërmimi në tokë)
- b. NP – 2 B (Ndërtime civile dhe industriale)
- c. NP – 3 B (Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industrial,veshje fasada)
- d. NP – 4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)
- e. N.P – 7 C (Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje)

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- a. N.S. – 2 A (Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)
- b. N.S. – 4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese)
- c. N.S. – 18 B (Punime topogjeodezike)

Konkretisht nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga operatori ekonomik T&XH shpk në Sistemin e prokurimeve Elektronike nuk rezulton të jetë paraqitur Licencë e kategorisë NP-7C (Ujësjiellësa, gazesjiellësa, vajësjiellësa, vepra kullimi e vaditje) në plotësim të kriterit sa më sipër. Nga ana e operatorit ekonomik rezulton të jetë dorëzuar Licenca me Nr.NZ 7784/17 nga ku rezulton se ofertuesi është i licensuar për kategorinë e licencës NP-7A Ujësjiellësa, gazesjiellësa, vajësjiellësa, vepra kullimi e vaditje, pra në një nivel më të ulët se ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit. Gjithashtu KVO vëren se ofertuesi ka paraqitur një deklaratë angazhimi për mbështetje në kapacitete me kompaninë I.D.K-Konstruksion ku parashikohet se:

Shoqëria “I.D.K – KONSTRUKSION” sh.p.k. deklaron dhe angazhohet se do të vërë në dispozicion të Shoqërisë “T&XH” sh.p.k., për qëllime të kësaj procedure prokurimi dhe gjatë gjithë periudhës së nevojshme për zbatimin e kontratës, kapacitetin e saj të licencimit në kategorinë NP-7, së bashku me punonjësit dhe mjetet e kërkuara për zbatimin e kontratës me objekt: “Ndërtim ujësjiellësa dhe nënobjekte të furnizimit me ujë dhe përmirësim rrjetesh ekzistuese në Rajonin Korçë.”, që zhvillohet nga Autoriteti Kontraktor SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A REF: 93644- 07-16-2026, si më poshtë:

• Z.Arjan Ramcaj – Inxhinier Hidroteknik •
Z. Eris Ndoni Hidraulik •

Z. Nikolin Paluca Hidraulik

- Z. Ergys Kolgjini Karpentier
- Z. Bujar Hysa Hekurthyes
- Znj. Entela Dalipi Teknik mekanike
- Z. Krenar Qinami- automakinist
- Z. Maksim Gjata Automakinist
- Z. Albert Kerxhalli Shofer kamioni
- Z. Elerd Dalipaj Shofer kamioni

MJETE: Fadrome, Minifadrome dhe Rimorkiator, Eskavator me zinxhire me çekic Stafi dhe mjetet do të jenë në dispozicion të Shoqërisë “T&XH” sh.p.k. gjatë gjithë periudhës për të cilën nevojitet prania dhe përdorimi i tyre në objekt.

Sa më sipër KVO vlerëson se mbështetja në kapacitete e ofertuesit tek shoqëria I.D.K – KONSTRUKSION” sh.p.k për kategorinë e licencës NP-7C të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit nuk mund të konsiderohet e vlefshme në rastin konkret.

Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe Disiplinimin e Punëve të ndërtimit” ndryshuar, në nenin 8, Drejtuesi Teknik”, parashikon: “1. Drejtuesi teknik është solidarisht përgjegjës me zbatuesin e punimeve, për të realizuar punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.

3. Drejtuesi i punimeve është pjesë e stafit të zbatuesit të punimeve i përcaktuar në Licencën e shoqërisë”. Ndërsa në Kreun IV “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë” të VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet:

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

Pika 2 e nenit 84 të LPP-së parashikon se Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm **nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë**, ndërsa pika 6 e po këtij neni përcakton se, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. Në rastin konkret subjekti tjetër I.D.K. Konstruksion referuar deklaratës së angazhimit për mbështetje në kapacitete rezulton të ketë ofruar vetëm kategorinë e Licencës por nuk rezulton se punët për të cilat kërkohet aftësia profesionale do të kryhen nga vetë ai apo akoma më tej nga stafi i tij. Në gjykimin e KVO nuk ka asnjë kuptim mbështetja në licencës e shoqërisë tjetër kur në fakt të gjitha punët për të cilat kërkohet mbështetja në kapacitete do të kryhen nga vetë ofertuesi i cili nga ana tjetër nuk është i licensuar për ti kryer ato.

Referuar përkufizimit “Licencë profesionale” është leja për ushtrimin e aktivitetit në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim me të cilin ka detyrimin të pajiset çdo subjekt juridik/fizik, privat ose publik, që dëshiron të ushtrojë veprimtari në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim dhe plotëson kushtet për t’u pajisur me një të tillë. Pra, Licenca profesionale është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë, i cili nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi si dhe Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente sic janë : -Vlera e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri; - Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë dhe Kapacitetet financiare. **Pra, edhe kryerja e punëve të zbatimit të punimeve sëbashku me vlerat financiare të tyre, shërbejnë në klasifikimin e kategorive të punimeve të përfituara nga zbatimit i punëve të ndërtimit.**

Pra referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, vlera financiare e përfituar nga kryerja e punimeve ndërtimore, ndikon në përfitimin e kategorive dhe klasifikimit të niveleve të licencës. Për rrjedhojë, përvoja në punët e zbatimit në ndërtim, **si dhe licenca profesionale**, së bashku me drejtuesin teknik të përfshirë në të, janë elemente të **lidhura ngushtë me subjektin që** do të realizojë zbatimin e punimeve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. LPP në nenin 14 të tij i jep mundësinë operatorit ekonomik në rastet kur nuk i plotëson i vetëm kriteret e kualifikimit të paraqitet në procedurë në formën e një bashkimi operatorësh ekonomikë. KVO në bazë të nenit 82 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 i ndryshuar ku parashikohet se Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që

përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme, vendos që ofertuesi të skualifikohet.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Nika shpk

J76705047U

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Operatori Ekonomik “Nika“ shpk skualifikohet nga procedura e prokurimit të sipërcituar për shkak se nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar shtojcen 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit“ pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik“ ku përcaktohet se:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme sipas percaktimeve të nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar si më poshtë:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për te vërtetuar përvojën e mëparshme duhet të paraqiten:

Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore:

a) Kontratën e Sipërmarrjes,

b) Situacionin përfundimtar të objektit

c) Aktin e Kolaudimit të objektit

d) Formular Vlerësimi

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Nëse kontrata është realizuar me subjekte private:

a) Kontratën e Sipërmarrjes,

b) Situacionin përfundimtar të objektit

c) Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore

d) Aktin e Kolaudimit të objektit

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, KVO konstaton se operatori ekonomik “Nika” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur Kontratë Pune Publike me objekt “Ndërtim i Ujësjellësit Bajzë, Bashkia Malësia e Madhe” me vlerë 322,507,370 lekë pa tvsh në të cilën ka marrë pjesë si bashkim operatorësh konkretisht Nika 37.58 % dhe 62.42% Ndregjoni: Referuar situacionit përfundimtar për këtë kontratë KVO vëren se operatori Nika shpk ka realizuar vetëm zëra punimesh që lidhen me gërmime, punime betonidhe jo punime hidraulike të ngjashme me objektin e prokurimit. Të gjitha zërat që lidhen me punimet hidraulike i ka realizuar anëtari tjetër i bashkimit Ndregjoni shpk. KVO vlerëson se operatori ekonomik Nika shpk nuk dëshmon se ka kryer punë të ngjashme me objektin e prokurimit për të gjitha zërat e preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor. Analiza lidhur me plotësimin e kriterit për punë të ngjashme nuk duhet të bëhet vetëm duke ju referuar në mënyrë sipërfaqësore titullit të kontratës por duhet vlerësuar në raport me zërat konkretë të punimeve të realizuara nga operatori ekonomik. Në rastin konkret KVO vëren se operatori ekonomik Nika shpk nuk dëshmon se ka realizuar punime të ngjashme për punime hidraulike zë i rëndësishëm në objektin që autoriteti kontraktor kërkon të realizojë.

Sa më sipër, KVO në bazë të nenit 82 pika 2 e VKM nr.285 date 19.05.2021 i ndryshuar ku parashikohet se *Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*, vendos që ofertuesi të skualifikohet.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Niem” shpk se, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 81,253,763 Leke pa tvsh, totali i pikëve të marra 288.90 pike është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Korçë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 94,189,999.05 lekë pa tvsh, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Marsida Kaluci

